



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Beledijesi

Në pajtim me nenin 12 shkronja c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenit 38 paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, 01. nr. 016-126211 të datës 06.11.2014 dhe në zbatim të nenit 5 paragrafi 10 të Rregullores për krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrjen e komunave në Bordet e drejtoreshave të ndërmarrjeve Publik rajonale të ujit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit me **29.02.2016**, miraton këtë:

VENDIM

1. Me anë të këtij vendimi **GARANTOHET** se investimet dhe qëndrueshmëria operative dhe financiare e Ndërmarrjes në themelim "Tregu" është në përputhje me kornizën afatmesme të shpenzimeve të Komunës së Gjilanit.
2. Me këtë vendim të njoftohet Ministria e Zhvillimit ekonomik gjegjësisht Njësia për Politika dhe Monitorim e Ndërmarrje Publike.
3. Për Zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik.
4. Ky akt hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në veb faqen e Komunës së Gjilanit.

01. nr.016-19892
Gjilan, 29.02.2016

Kryesuesja e Kuvendit

Valentina Bunjaku-Rexhepi

ARSYETIMI :

Me lejonin të ju njoftoj se është aprovuar Plotësimi Ndryshimi i Rregullores për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe pjesëmarrja e Komunave në Bordin e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit .

Njësia për Politikë dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike kërkon nga ne, që kërkesa të ri-përsëritet dhe një here dhe të plotësohen duke u mbështetur në rregulloren bazë dhe në plotësimin ndryshim të saj.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka dorëzuar kërkesën për themelimin e ndërmarrjeve të re publike lokale " Tregu" sh.a, me gjithat Ndryshimi i Rregullores për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale kërkesa e jone duhet të ri-përsëritet.

Dokumentacioni ka përmbajtur :

1. Kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale janë:

- 1.1 ndërmarrja duhet të jetë Shoqëri Aksionare me aksione të komunës themeluese;
- 1.2 kapitali themeltar fillestar i shoqërisë aksionare duhet të jetë në shumën prej dhjetë mijë euro (10.000 €).
- 1.3 ndërmarrja publike lokale, si Shoqëri Aksionare, është person juridik në pronësi të aksionarëve të saj, juridikisht e ndarë dhe e veçantë nga aksionarët e saj.

Raporti i arsyeshmërisë për krijimin e ndërmarrjes publike lokale duhet të përmbajë:

1. raportin për qëndrueshmërinë financiare dhe operative të ndërmarrjes
2. strukturën organizative;
3. planin e biznesit dhe planin e buxhetit
4. draftin e statutit dhe dokumente tjera

Pse duhet të ri-përsëritet kërkesa?

Kriteri nga plotësimi ndryshimi i rregullores

Neni 5 i Rregullores bazë pas paragrafit 9, shtohet paragrafi i ri 10, me tekstin si në vijim :

"Komunat duhet të garantojnë me shkrim përmes nënshkrimit të Kryesuesit të Kuvendit Komunal dhe Kryetarit të Komunës për investimet dhe qëndrueshmërinë operative dhe financiare në përputhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të Komunës që ka paraqitur kërkesën".

Në rast se kërkesa ka të bëjë me krijimin e Ndërmarrjes Publike Lokale nga shthurja e Ndërmarrjes së përbashkët ju lutem të i referoheni nenit 6.A të plotësimin ndryshimit të rregullores.

Duke u bazuar në arsyetimin e cekur më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës të marrë vendim ashtu siç është përshkruar në diapozitivin e tij e që është në përputhje me nenin 5 të rregulloreve të lartshënuar të aprovohet kërkesa jonë për të hapur rrugë themelimit të ndërmarrjes së re publike lokale "Tregu" sh.a

Me respekt!

z. Agim Zuzaku, Drejtor

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik